



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim

Mbledhja nr. 89

Prishtinë, më 8.10.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Milazim Salijaj, Isak Shabani, Ekrem Mustafa, Jetmire Vrenezi, Albena Reshitaj, Salih Zyba dhe Ganimete Musliu.

Munguan: Besian Mustafa dhe Samra Ilijazi.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësuesit sipas listës.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 17.9.2024;
3. Shqyrtimi i Draft Planit të punës për sesionin vjeshtor 2024;
4. Shqyrtimi i Propozimit të Organizatave Joqeveritare;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Komisioni, me 8 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 17.9.2024

Komisioni, me 7 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim (deputetja Ganimete Musliu, abstenoj për shkak se nuk ka qenë në këtë mbledhje), e miratoi procesverbalin nga dt. 17.9.2024

3. Shqyrtimi i Draft Planit të Punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2024

Kryetarja e paraqiti për diskutim Draft Planin e Punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2024, i cili tha se është përgatitur bazuar në aktivitetet e komisionit në procedurë të mbetur nga sesioni pranveror dhe i cili përfshinë vazhdimin e shqyrtimit të projektligjeve, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe aktiviteteve të tjera, si dhe duke bazuar në programin legjislativ të

Qeverisë për vitin 2024 . Objektivat kryesore të këtij plani janë shqyrtimi dhe amendamenti i 28 projektligjeve, prej tyre 11 projektligje që janë në procedurë të shqyrtimit në komision dhe 17 projektligje që pritet të procedohen në Kuvend në sesionin vjeshtor, bazuar në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2024. Do të vazhdojë mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve si dhe monitorimi i resorëve të Qeverisë dhe të Agjencive të pavarura, që bien në kompetencën e komisionit. Gjithashtu, do të shqyrtojë edhe dokumentet e tjera nga fushëveprimi i tij., etj.

Ajo në fund tha se kjo është një përmbledhje e planit të punës për sesionin vjeshtor 2024, i cili mund të plotësohet sipas nevojave dhe prioriteteve të Komisionit edhe më vonë, dhe pasi që nuk kishte propozime konkrete nga deputetët për ta plotësuar atë, *ajo i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se komisioni me 8 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, nxori këtë,*

Përfundim:

Miratohet Plan i Punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2024

4. Shqyrtimi i Propozimit të Organizatave Joqeveritare

Kryetarja, tha se kemi marrë një e-mail nga, organizatat që avokojnë për të drejtat mjedisore, Pishtarët, Eko-Z dhe OMM Gjethi, të cilët e ftojnë komisionin të bëjnë një vizitë urgjente në Lumëbardhin e Deçanit për t'u njohur nga afër me gjendjen e rënduar të lumit dhe me rrezikshmërinë që paraqet rezervuari akumulues i hidrocentralit Lumëbardhi nga operimet e hidrocentraleve pa u respektuar Ligji i Ujërave dhe Ligji për Mjedis.

Ajo tha, se rasti hidrocentraleve në Lumëbardhë është në Gjykatën Kushtetuese, pasi që Gjykata Supreme nuk iu ka dhënë të drejtë këtyre organizatave në lidhje me shkeljet ligjore. Pastaj ajo pyeti deputetet se çfarë të bëhet?

Ganimete Musliu, tha se është më mirë pasi që rasti është në gjykatë, në të rrëmë më larg kësaj dhe propozoi që ti dërgohet një e-mail nga kryetarja në emër të komisionit për shqetësimet e ngritura dhe për këtë të njoftohen edhe OJQ-të.

Salih Zyba, tha se është mirë të dilet në terren me pa gjendjen, ndoshta është më mirë të ftohen këto OJQ në Komision, për t'i dëgjuar.

Albena Reshitaj, tha se është e informuar në lidhje me këtë problematikë dhe se gjithçka që ka ndodhë është politike. Ajo përmendi aktivisten e kësaj çështjeje, Shpresa Loshaj që ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm, gjithashtu e përkrahu ftesën për OJQ-të në Komision

Milazim Salijaj, e përkrahu vizitën në Lumëbardhë të Deçanit. Gjithashtu, edhe Ekrem Mustafa.

Kryetarja në fund në emër të komisionit përfundoi se një vizitë në Lumëbardhin e Deçanit të organizohet në kuadër të Mbikëqyrjes së Ligjit për Ujëra të cilin e udhëheq deputetja Albena Reshitaj, prandaj për kohën e vizitës dhe modalitetet e tjera vendoset në këtë grup.

5. Të ndryshme

- Salih Zyba, si kryesues i grupit punues për Projektligjin për faturat e kulturave bujqësore dhe flet magazinat, i ftoi anëtarët e tjerë të këtij grupi që të marrin pjesë në takime. Pastaj deputetja Ganimete Musliu me vetiniciativë u bë anëtare e këtij grupi punues.
- Ganimete Musliu, tha se ka marrë disa ankesa të qytetarëve në Prishtinë për mungesë të higjienës në disa markete, aty vërehet prania e madhe e mizave dhe ndotjes. Prandaj kërkoi që ti kërkohet AUV-it të bëjë inspektimin e tyre për masa higjienike.

Kryetarja tha se do ti shkruajmë një letër AUV-së për këtë çështje.

- Në fund të kësaj mbledhje u prezantuan dy praktikante të reja në komision: Besarta Ibrahimimi dhe Nora Lika.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Fitore Pacolli-Dalipi,

Kryetare e Komisionit